



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.29-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj, anëtarë, duke vendosur në lidhje me kërkesën për rishqyrtim ZP.Anr.29-4/2025, të subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it ZP.Anr.29/2025 të datës 22.12.2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 29.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar Kërkesa për Rishikim ZP.Anr.29-4/2025 e datës 25.12.2025, e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit të PZAP-it, ZP.Anr.29/2025 të datës 22.12.2025.

Arsyetim

Paneli me vendimin ZP.Anr.29/2025 e datës 22.12.2025, e kishte miratuar ankesën e subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, parashtuar kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, dhe i ka shqiptuar dënim më gjorbë në lartësi prej 2,000.00Euro (dymijë) Euro, duke e detyruar subjektin politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, që gjorbën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

PZAP-i, me datë 25.12.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtim e vendimit ZP.Anr.29-4/2025 e datës 25.12.2025, të subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, me të cilën pretendohet se ashtu siç kemi cekur edhe në përgjigje në ankesë, që gjendja faktike e theksuar në ankesën e IRDK, e rrjedhimisht edhe me vendimin e atakuar, nuk korrespondon me realitetin e paraqitur nga PLE, kjo për faktin se z.Bekim Tallamishi, nuk është anëtar i subjektit politik PLE, dhe i njëjti që nga viti 2020 është larguar nga PLE dhe për më tepër Bekimi jeton jashtë Kosovës dhe ne nuk kemi asnjë informatë se për çfarë arsye ka deklaruar si në videon përkatëse. Tutje në kërkesë theksohet se subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane vazhdimisht ka paralajmëruar mbështetësit e saj në lidhje me dispozitat ligjore që na obligojnë, e sidomos me nenin 33, par.6 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se subjekti politik ka për obligim njoftimin dhe parandalimin e anëtarëve, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e këtij ligji dhe Kodi, ashtu që e sqarojmë për PZAP se ne kemi ndërmarrë gjitha masat për respektimin e këtyre dispozitave ligjore por jo të gjithë anëtarë ti binden lutjeve të subjektit politik që e mbështetin.

Prandaj, gjoba e shqiptuar për PLE-në, është shumë e lartë dhe me respekt kërkojmë nga PZAP që ta rishqyrtoj vendimin e atakuar, kjo për faktin se ne si subjekt politik, vazhdimisht kemi vështirësi si financiare për të siguruar ekzistencën dhe funksionimin e mirëfillte të aktivitetit politik, e aq më tepër duke pasur parasysh se jemi parti nga komuniteti egjiptian dhe nuk kemi mbështetje të mjaftueshme nga donator apo financues sikur që kanë partitë tjera nga popullsia shumicë në Kosovë dhe një gjobë e tillë prej 2,000 euro na rëndon shumë funksionimin dhe zhvillimin e aktivitetit Politik. Përveç kësaj, konsiderojmë se video e publikuar nga z.Tallamishi nuk shihet se është bërë ndonjë veprim i ndaluar sipas nenit 4 të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, por që IRDK në ankesën e paraqitur ka ekzagjeruar deklarinimin dhe pretendimet për Shkelje dhe më pastaj PZAP i ka marrë si të mirë qenë këto pretendime dhe pa i shqyrtuar drejtë gjendjen faktike ka vendosur si në vendimin e atakuar për gjobën prej 2,000 ndaj PLE-së. Përfundimisht, duke u bazuar në gjendjen faktike, provat që gjenden në shkresat e dorëzuara me përgjigje në ankesë, e vërtetojnë faktin se në asnjë mënyrë nuk mund flitet për një fabrikim të votave apo të ngjashëm, e kjo për faktin se z.Tallamishi, me veprimet e tij nuk ka shkelur dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Kodin e Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit ZP.Anr.29/2025 të datës 22.12.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesës për rishqyrtim të datës 25.12.2025, për shqyrtimin e vendimit ZP.Anr.29/2025, të datës 22.12.2025, rrjedh se subjekti politik PLE, nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesën e tij, kjo për faktin se subjekti politik PLE, nuk i ka bashkangjitur asnjë provë kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht nuk ka arritur të dëshmojë qartë pretendimet e theksuara në kërkesë gjegjësisht se z.Tallamishi nuk është mbështetës apo përkrahës i subjektit politik PLE. Përkundër kësaj i njëjti në kërkesën e tij thekson se ka paralajmëruar mbështetësit e saj në lidhje me dispozitat ligjore që i obligojnë, sipas nenit 33, par.6 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mirëpo i njëjti nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se është ndërmarr ndonjë veprim i tillë apo se ka bërë përpjekje. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura vendimi i kontestuar me rishikim, rezulton të jetë i drejt, i ndërtuara mbi fakte, prova dhe të mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në kërkesë, dhe meqenëse parashtruesi i kërkesës nuk i ka bashkangjitur asnjë prove të vetme kërkesës me të cilat do të i vërtetojë pretendimet e tilla në kërkesë, andaj veprimet e subjektit politik PLE paraqesin shkelje të dispozitave të nenit 6 par. 2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet qartazi se vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në kërkesë nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lartë.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se, *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZP.Anr.29-2/2025, datës 29.12.2025,

Kryesties i Panelit
Skender Çoçaj



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*